

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm**, me gjyqtarene vetme gjykuese Fatime Dërmaku, me zyrtaren ligjor Edona Grajçevci, në çështjen penale, kundër të pandehurit A.M., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5790/17, të dt.06.11.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt.07.09.2018, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5790/17, të dt.06.11.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMORË

**I pandehuri:** A.M., nga i ati H.1, nënës F., e gjinisë H.2, i lindur me datë ..., në V., me vendbanim në fshatin S. i P., Komuna V., me numër personal ..., shqiptar, shtetasee Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTORË

**S e p s e:** Me datë 16.09.2017, rreth orës 10:40, në rrugën "U." në P.1 i pandehuri ka shkel Ligjin Mbi Rregullat e Trafikut Rrugor, (nenin 53 dhe 120), në atë mënyrë duke drejtuar automjetin Kombi të tipit "Daimler" me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia duke menduar me mendje lehtësi se deri te aksidenti nuk dë të vij, ka rrezikuar komunikacionin, dhe ka vu në rrezik jetën e njerzëve, në atë mënyrë që nuk ka mbajtur distancën e sigurisë gjatë lëvizjes, ku me pjesën e përparme të automjetit të tij e godet në pjesën e pasme automjetin "Opel Pikap" me targa ..., të cilën e drejtonte i dëmtuari ..., ku me çrast pëson edhe lëndime të lehta trupore me pasojë të përkohshme për shëndetin,-

me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dënuari dënimin e shqiptuar me gjobë mund ta paguajë me dy këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet)€ të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88€** dhe ekspertizën mjekoligjore në shumë prej **20 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari:H.B., me vendbanim në fshatin S., Komuna P.2,për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.5790/17, të dt.06.11.2017 e ka akuzuar A.M., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjituranë shkresat e lëndës, dhe atë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugorë ing. A.H. e dt.17.10.2017 ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit Dr.N.U. të datës 09.10.2017, si dhe dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri A.M., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par.1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.5137/17**  
**Më datë 07.09.2018**

Zyrtarja Ligjore  
Edona Grajçevci

Gjyqtarja,  
Fatime Dërmaku

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.